



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-1515 prot.

Tiranë, më 06/02/2023

Lënda: **Kthim përgjigje**

✓
QENDRËS "RES PUBLICA"
Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-1515, datë 23.01.2023 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-1515/1, datë 03.02.2023, si vijon:

"Referuar kërkesës për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, të ardhur pranë Bashkisë së Tiranës ju bëjmë me dije se:

Drejtorja e Emergjencave Civile, po ju dërgon bashkëlidhur kopje të dokumentave që ne disponojmë për procedurën e ndjekur për këtë rast, si më poshtë:

- Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.102, datë 28.09.2020.
- Kopje të oponencës teknike ku është mbështetur ky vendim.

Në vijim, për shkak të ankesave të shumta të banorëve të këtij objekti Instituti i Ndërtimit ka realizuar kryerjen e një Akt Ekspertize të Thelluar, ku ka rekomanduar përforcimin e kësaj ndërtese.

E ndodhur para këtij fakti, Bashkia Tiranë ka pezulluar zbatimin e VKB-së së sipërcituar dhe i është drejtuar Institutit të Ndërtimit me shkresë me nr. 10368/1 prot., datë 29.06.2021, me kërkesën për saktësim mbi vlerësimin e gjendjes teknike të ndërtesës 12-13 në rrugën "Benardin Palja", Njësia Administrative nr. 6.

Instituti i Ndërtimit me shkresën e Institutit të Ndërtimit me shkresën me nr. 422/1 prot., datë 12.07.2021, të protokolluar në Bashki me nr. 10368/2 prot., datë 14.07.2021, ka kthyer përgjigje dhe pas rivlerësimit teknik ka përcjellë konkluzionin që ky objekt duhet të "Përforcohet".

Sa më sipër, nuk disponojmë një pjesë të dokumentave të kërkuar dhe momentalisht po merremi me përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor për t'ja paraqitur Këshillit Bashkiak, propozimin për korrigjim të VKB-së nr. 102, datë 28.09.2020 për shkak të ndryshimit të nivelit të Dëmit nga DS5 në DS4 për t'i hapur rrugë procesit të hartimit për projektin të rikonstruksionit/përforcimit të objektit në fjalë”.

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha





VE N D I M

Nr. 102, datë 28.09.2020

“PËR

PRISHJEN E DETYRUAR TË NDËRTESES PRIVATE (PALLATI NR. 12 DHE NR. 13 RRUGA “BERNARDIN PALAJ”), NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 34, nenit 35, të Aktit Normativ me nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Ligjit nr. 45/2019, “për mbrojtjen civile”, Vendimit nr. 887, datë 24.12.2019 “për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendim nr. 80, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësi administrative 6, zona kombinat, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese” si edhe në vijim të shkresës me nr. 1832/2, prot., datë 28.07.2020 të Institutit të Ndërtimit drejtuar Bashkisë Tiranë (protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 24968/1, prot., datë 28.07.2020), memos nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile nr. 30966 prot, datë 17.09.2020, me objekt “Mbi njohjen me aktekspertizat e thelluara të kryera nga Operatorët Ekonomikë të kontraktuara nga Bashkia Tiranë, Oponencat Teknike të kryera nga Instituti i Ndërtimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës private pallati nr. 12 dhe nr. 13 rruga “Bernardin Palaj”, në Njësine Administrative nr. 6, Tiranë, mbështetur në akt ekspertizën e thelluar dhe konkluzionin e oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. ~~Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrçimit Publik, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.~~

5. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objekteve sipas këtij vendimi, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për shembjen e objekteve bëhet në prani të përfaqësuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.

6. Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit kërkon asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

7. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, si dhe afishohet në stendat publike pranë njësisë administrative nr. 6.

8. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe Njësisë Administrative nr. 6, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.


KRYETARI

TONI GOGU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT



Nr. 1832/prot
/2

Nr. 25262/Prot. Date 28/10/2020

Lënda: Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar

BASHKISË TIRANË

Sheshi "Skënderbej" nr.2, Tiranë

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.24968Prot, datë.24.07.2020, protokolluar me tonën me Nr.1832/Prot, datë.24.07.2020, "Kërkesë për kryerjen e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar", Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të objektit: "PALLATI 12 DHE 13", RRUGA "BENARDIN PALAJ", TIRANË, konkludojme se:

Akt ekspertizë e hartuar, nga shoqëria INSTITUTI "DEKLIADA-ALB", jep analizë të gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhenat nga projekti i zbatimit, dëmtimet, etj.

Sipas Akt ekspertizës objekti është një godinë me 4 kate dhe pjesërisht me 3 kate mbi tokë dhe 1 kat podrum. Objekti është i rregullt në vertikalisht dhe plan. Objekti në fjalë është ndërtuar rreth viteve 1960. Asokohe objekti i shërbente ushtrisë dhe kishte vetëm katin përdhe. Katet e sipërme janë shtuar më vonë. Objekti ka sipërfaqe rreth 200 m²/kat. Sipërfaqja totale llogaritet rreth 695 m² në total. Sistemi strukturor i godinës është me muraturë mbajtëse tulle silikate.

Objekti ka sistem konstruktiv me rama hapsinore b/a dhe themele me plinta b/a. Materialet e ndërtimit nga provat rezultojnë me beton C16/20 për katin përdhe, ndërsa për katet e sipërme rezulton i një klase C25/30. Përsa i përket çelikut, ky i fundit është me fyk=25000N/mm² për katin përdhe, ndërsa për katet e sipërme ai është i tipit B500C. Niveli i njohjes së objektit është KL2. Koeficienti i sigurisë për këtë objekt është marrë 1.35 (Limited Knowledge).

Në dokumentet e paraqitura për oponencë teknike është dhënë dhe projekti i perforcimeve i hartuar nga shoqëria INSTITUTI "DEKLIADA-ALB", shoqëruar me raportin teknik përkatës.

Në raportin e vlerësimit strukturor autorët shprehin:

Perfundimisht, mund të konkludojmë, që kjo ndërtesë në gjendjen ekzistuese i plotëson kushtet e sigurisë dhe qendrueshmërisë për ngarkesa statike por nuk i plotëson ato për ngarkesa dinamike sizmike, referuar gjendjes së pare kufitare si dhe kriteret e shërbimit në ulje dhe deformime referuar gjendje së dyte kufitare (gjendjes kufitare të shfrytëzimit) duke u bazuar në Eurocode për aktivitet sizmik me PGA = 0.260 g.



Struktura e objektit ne gjendjen egzistuese nuk i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per nje vend sizmik sic eshte Tirana dhe duhet ti nenshtrohet restaurimit dhe perfocimit, mbi bazen e specifikave teknike te projektit perkates bashkengjitur.

Rekomandojme qe struktura e mesiperme te perforcohet dhe te restaurohet konform projektit perkates.

Rekomandime per nderhyrjet strukturale te nevojshme per kthim te strukturës konform kushteve teknike dhe pershtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve te tjera te barasvlefshme.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.

Në bazë të analizave të kryera autorët kanë dal në përfundimin që struktura të kthehet në standartet e sigurisë të kërkuara nga kodet e sotme Europiane të projektimit duhet ti nënshtrohet ndërhyrjeve përforcuese.

Projekti i përforcimit konsiston në përforcimin e elementëve strukturore.

Kemishimi i te gjitha kolonave te katit -1 me trashesi 15 cm. Armimi te behet me 12 shufra terthore gjatesore $\phi 25$ dhe stafa $\phi 10$ cdo 15 cm.

Kemishimi i te gjitha kolonave te katit perdhe me trashesi 15 cm. Armimi te behet me 12 shufra terthore gjatesore $\phi 25$ dhe stafa $\phi 10$ cdo 15 cm.

Kemishimi i kolonave te katit te pare nga aksi (A – C) me trashesi 15 cm. Armimi te behet me 12 shufra terthore gjatesore $\phi 25$ dhe stafa $\phi 10$ cdo 15 cm.

Muret mbajtese te vishen me beton torcrete (me rezistence 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diameter 5 mm. Zgarat do te lidhen me shufra terthore dhe do te vendosen ne te dyja faqet e mureve.

Soletat te perforcohen duke perdorur zgara te tipeve T 188 siper dhe T 92 poshte. Nga siper soletat te vishen me beton C20/25 dhe nga poshte te vishen me beton torcrete. Lidhja e te dyja shtresave te behet me shufra terthore te cilat do te futen ne zonat e bashkimit te paneleve. Soletat gjithashtu do te lidhen me muraturen nepermjet shufrave te cilat do te inkastrohen ne faqen e jashtme te murit me ane te pllakave metalike.

Projekti i përforcimit është i detajuar dhe me shënimet e nevojshme teknike. Materialet që do të përdoren janë konform kushteve teknike. Mbi bazën e këtij projekti është hartuar dhe një preventiv me një vlerë të punimeve të përforcimit 21,455,094 lekë me tvsh e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para $695 \text{ m}^2 * 32113 \text{ lekë/m}^2 = 22,318,535.00$ duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është më e madhe se 70 %, (96.1% > 70%).

Pra si përfundim mund të themi se Akt ekspertiza e thelluar për objektin "PALLATI 12 DHE 13", Rruga "Benardin Palaj", është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.



Nga analiza e kësaj ekspertizë dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit dalim si përfundim që “PALLATI 12 DHE 13”, RRUGA “BENARDIN PALAJ”, TIRANË duhet të Priset dhe të Ndërtohet e Re.

Projekti i ndërtimit pallatit të ri të hartohet konform Eurokodeve 8 për nivelin e performancës për rastin e efekteve sizmike.


Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Projekti si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqëri të licensuara, për këto lloj punimesh. Përgjegjësia për projektin është autorit të projektit të projektit

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ing. Agim Hesenliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT



Tirane, më 12.1.2021

Nr. 422/1 prot

Lënda :

Kthim përgjigje me nr. 10368/1 prot, dt. 29.06.2021

Drejtuar :

Drejtorisë së Emergjencave Civile

Bashkia Tiranë


Adresa : Sheshi "Skenderbej", Nd.2, Kodi postar 1001, Tiranë

Referur shkresës suaj me nr. 10368/1 prot, datë 29.06.2021, protokoluar me tonën me nr. 422/1 prot datë 01.07.2021, ju bëjmë me dije se për objektin Ndërtesa nr. 13 në Rrugën "Bernardin Palja", Njësia Admin. 6, Tiranë, nga ana e Instituti i Ndërtimit janë realizuar dy Akt Ekspertiza të Thelluara me 2 grupe të ndryshme pune dhe konkluzioni i vlerësimit të objektit në të dyja Akt Ekspertizën e Thelluar është "Përforcim".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

Artan SHKRELI

DREJTOR I PËRGJIGJSHËM





BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI,
ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 10368/prot.

Tiranë, më 29, 6, 2021

Lënda: Kërkesë për saktësim mbi vlerësimin e gjendjes teknike të ndërtesës 12-13 në rrugën "Bernardin Palja", Njësia Administrative Nr. 6

INSTITUTIT TË NDËRTIMIT
Rr. "Myslym Keta" Brar, Tiranë

Për dijeni : INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT

Referuar shkresës së ardhur nga Instituti i Ndërtimit me nr. 422 prot., datë 05.02.2021 protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 10368 prot., datë 05.03.2021, jeni shprehur se dërgoni aktekspertizën e thelluar për ndërtesën nr. 13, 3-4 kate me një sipërfaqe 810 m² që ndodhet në rrugën "Bernardin Palja", Njësia Administrative Nr. 6, por theksojmë se nuk ka dokumentacion bashkëlidhur.

Gjithashtu, lidhur me objektin e sipërcituar, i cili u dëmtua nga tërmeti i datës 26.11.2019, referuar akt konstatimit vizual të mbajtur nga grupi i inxhinierëve të Institutit të Ndërtimit të cilin e keni përcjellë me shkresën nr. 873 prot., datë 16.02.2019 protokolluar në Bashki me nr. 46034/23 prot., datë 16.02.2020 (sipas kërkesës tonë me nr. 46034 prot., datë 05.12.2019), shprehni se :

"rekomandohet të bëhet një ekspertizë e thelluar për strukturën, duhet që gjatë punimeve të evakohen banorët",

Në këto kushte, Bashkia e Tiranës ka ndjekur procedurën për kryerjen e aktekspertizës së thelluar sipas rekomandimeve të Institutit të Ndërtimit, të lëna në aktkonstatimin vizual nëpërmjet kontraktimit të operatorëve ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi.

Pasi ka përfunduar kryerja e aktekspertizës së thelluar, Bashkia e Tiranës i ka përcjellë kërkesën për kryerjen e oponentës teknike Institutit të Ndërtimit së bashku me aktekspertizën e thelluar për pallatin 12-13 në rrugën "Bernardin Palja", Njësia Administrative Nr. 6 me shkresën me nr. 24968 prot., datë 24.07.2020.

Instituti i Ndërtimit ka kthyer përgjigje dhe ka dërguar opionencën teknike për pallatin 12-13 në rrugën "Bernardin Palja", Njësia Administrative Nr. 6 me shkresën me nr. 1832/2 prot., datë 28.07.2020 protokolluar në Bashki me nr. 24968/1 prot., datë 28.07.2020 ku shprehet :

"Pra si përfundim mund të themi se Akt ekspertiza e thelluar për objektin "Pallati nr. 12 dhe 13", Rruga: "Bernardin Palja", është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.

Nga analiza e kësaj ekspertizë dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit dalim si përfundim që "Pallati nr. 12 dhe 13", Rruga: "Bernardin Palja", Tiranë duhet të Prishet dhe të Ndërtohet i Ri."

Në vijim, sipas aktekspertizës së thelluar të mbështetur nga opionenca e Institutit të Ndërtimit, Këshilli Bashkiak vendosi prishjen e detyruar të këtij objekti me VKB Nr. 102 Datë 28.09.2020 "Për prishjen e detyruar të ndërtesës private"

Me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 102 Datë 28.09.2020 është përgatitur dokumentacioni për prokurim dhe sipas procedurës së tenderimit, bazuar në kontratën e sipërmarrjes të nënshkruar midis dy palëve, operatorit ekonomik të kontraktuar dhe Bashkisë Tiranë me objekt "Demolimi dhe evadimi i objekteve ndërtimore".

Sa më sipër, të ndodhur përpara faktit ku për të njëjtin objekt këni përcjellë zyrtarisht dy vlerësime të ndryshme, kërkojmë nga ana juaj të saktësoni situatën lidhur me ndërtesën nr. 13 në rrugën "Bernardin Palja", Njësia Administrative Nr. 6 dhe mendimin tuaj përfundimtar për gjendjen teknike të objektit si dhe masat që duhen marrë në vijim.

Ju uroj punë të mbarë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurel Cuko

